

Informacion nga rrethi Wittmund për vaksinimin kundër koronavirusit

1

Kush mund të vaksinohet kundër koronavirusit?

Që nga 7 qershori 2021 mund të vaksinohen të gjithë njerëzit dymbëdhjetë vjeç e sipër që jetojnë në Gjermani. Së shpejti do të ketë edhe një vaksinim për fëmijët nën dymbëdhjetë vjeç.

Pse duhet të vaksinohem kundër koronavirusit?

- Vaksinimi të mbron ty, familjen tënde dhe të gjithë njerëzit e tjerë nga infektimi.
- Ti jep ndihmesën tënde, që jeta jonë të kthehet përsëri në normalitet, siç ishte para pandemisë.
- Njerëzit e vaksinuar kanë disa avantazhe: Për shembull, ata nuk kanë nevojë të paraqesin testin kundër koronavirusit dhe mund të udhëtojnë më lehtë.

A është i rrezikshëm vaksinimi?

Vaksinat janë testuar me kujdes nëse tolerohen nga trupi, nëse janë të sigurta dhe nëse kanë efekt. Nëse ke ndonjë dyshim, mund të flasësh me mjekun tënd të familjes.

A jam i detyruar të vaksinohem?

Vaksinimi është me vullnet të lirë, por rrethi Wittmund të rekomandon që të vaksinohesh.

A duhet të paguaj ndonjë gjë për vaksinimin?

Vaksinimi është falas.

Më shumë informacione në disa gjuhë të tjera mund të gjesh këtu:



Nëse ke ndonjë pyetje, mund të kontaktosh me Shërbimin e Informacionit të Ministrisë Federale Gjermane të Shëndetësisë në numrin falas të telefonit 0800 000837, në anglisht, arabisht, turqisht dhe rusisht.




Informacion nga rrethi Wittmund për vaksinimin kundër koronavirusit

2



Si mund të regjistrohesh për vaksinimin?

Për këtë ka disa mënyra: Ti mund ...

- ... të telefonosh **mjekun tënd të familjes** dhe të kërkohesh vaksinim. Ti do të vaksinohesh tek mjeku i familjes, sapo të vijë vaksina edhe për ty.
- ... të pyesësh Këshillimin për Migracionin të Shoqatës **AWO** të Rrethit Wittmund (Friedenstraße 16, Wittmund, Tel.: 04462 6634, Informacione: www.fh-wtm.de). 
- ... të telefonosh **në linjën telefonike të Landit Niedersachsen**. Numri falas i telefonit është: 0800 9988665. Ndoshta do të të duhet ta provosh disa herë deri sa të lidhesh, pasi ka shumë njerëz që telefonojnë në këtë numër. Ti do të japësh të dhënat e tua dhe do të futesh në listën e pritjes. Nëse ka mjaftueshëm vaksina, ti do të marrësh një takim për në qendrën e vaksinimit në Esens.
- ... mund të regjistrohesh në **portalin e vaksinimit online të Landit Niedersachsen**. Adresa e internetit është: www.impfportal-niedersachsen.de. Këtu mund të vendosësh të dhënat e tua. Për këtë të duhet edhe një celular. Në celular do të të dërgojnë një mesazh. Kur të ketë ardhur mesazhi, ti mund të zgjedhësh direkt një orar takimi ose të futesh në listën e pritjes. Pastaj do të marrësh një konfirmim me postë ose email. Nëse ka mjaftueshëm vaksina, ti do të marrësh një takim në qendrën e vaksinimit në Esens.

Ku ndodhet qendra e vaksinimit të rrethit?

Qendra e vaksinimit të rrethit Wittmund është vendosur në një hostel të rinjsh, në Esens. Ti do të vaksinohesh atje, nëse je regjistruar përmes linjës telefonike të vaksinimit ose përmes portalit të vaksinimit të Landit Niedersachsen. Adresa është:

DJH Jugendherberge Esens-Bensersiel
Grashauser Flage 2
26427 Esens

Shfrytëzoje rastin! Vaksinohu kundër koronavirusit!



LANDKREIS WITTMUND
INTEGRATION